

Xhensila Pine

Komisionere

Diplomuar “Jurist” në vitin 1999 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Nga viti 2006 deri në 2009 ka kryer studimet pasuniversitare pranë Katedrës të së drejtës publike në Universitetin e Tiranës. Aktualisht po mbron gradën shkencore “Doktor” pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike. Në vitet 2004-2005, znj. Pine ka punuar si juriste në Bankën Kombëtare Tregtare. Më tej, në 2006-2007, ajo ka mbajtur detyrën e përgjegjëses së sektorit të inspektimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Gjatë kësaj periudhe, znj. Pine ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, si dhe ka kryer trajnime të ndryshme brenda e jashtë vendit në këtë fushë. Nga viti 2011 ka qenë juriste e më pas Administratore e shoqërisë me kapital shtetëror “Bursa e Tiranës” sh.a. Znj. Xhensila Pine ka një eksperiencë rreth 17-vjeçare në fushën e mësimdhënies, fillimisht si lektore e jashtme në Universitetin e Tiranës, nga viti 2000-2008, dhe më pas në universitete të ndryshme jopublike të vendit, për të drejtën kushtetuese. Ajo ka qenë gjithashtu trajnere pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe të drejtën e informimit. Ajo është njohëse e mirë e frëngjishtes dhe anglishtes. Në qershor 2017, juristja Pine u emërua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë si Komisionere në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.